



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2021:048456

Datë: 15.03.2024

Numri i dokumentit: 05459698

PPP.nr.129/22

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni civil, gjyqtari Faton Ajvazi, me sekretaren juridike Makfire Reçica, në çështjen përmbartimore të kreditorit B.S. nga fsh ..., Komuna e Shtërpçës, kundër debitorëve B.Sh. nga Ferizaj, rr “...” dhe M.S. nga Ferizaj, rr “...” ... nr....., të cilin me autorizim e përfaqëson av Burhan Qosa nga Ferizaj, për pagesën e borgjit, duke vendosur për prapësimin e ushtruar nga i autorizuari i debitorit M.S., me datë 15.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I.PRANOHET pjesërisht prapësimi i të autorizuarit të debitorit M.S., i ushtruar kundër urdhrit për përmbartim P.nr.22/2021, të datës 28.01.2021, i lëshuar nga përmbartuesit privat S.R. nga Prishtina, sa i përket caktimit të përmbartimit ndaj debitorit B.Sh. edhe atë për shumën e borxhit prej 2,375 euro, dhe për shpenzimet e përmbartimit për debitorin B.Sh., si dhe kamatës së kërkuar nga kreditori prej 8% nga dita e arritshmërisë së kërkesës dhe **SHFUQIZOHET** urdhri për përmbartim sa i përket caktimit të përmbartimit ndaj debitorit B.Sh. edhe atë për shumën e borxhit prej 2,375 euro, dhe për shpenzimet e përmbartimit për debitorin B.Sh., si dhe kamatës së kërkuar nga kreditori prej 8% nga dita e arritshmërisë së kërkesës.

II.REFUZOHET si i pabazuar prapësimi i të autorizuarit të debitorit M.S., i ushtruar kundër urdhrit për lejimin e përmbartimit P.nr.22/2021, të datës 28.01.2021, sa i përket shumës së borxhit të mbetur prej 2,375 euro dhe për shpenzimet e përmbartimit, si detyrim i mbetur për debitorin M.S. dhe **MBETET** në fuqi urdhri për lejimin e përmbartimit vetëm sa i përket shumës së borxhit të mbetur prej 2,375 euro dhe për shpenzimet e përmbartimit, si detyrim i debitorit M.S. ndaj kreditorit B.S..

A r s y e t i m

Me urdhrin P.nr.22/2021, të datës 28.01.2021, përmbaruesi privat S.R., e ka caktuar përmbarimin e propozuar nga kreditori B.S., kundër debitorëve B.Sh. dhe M.S., për detyrimin e debitorëve, për pagesën e borxhit në shumë të përgjithshme prej 4,750 euro, në mënyrë solidare, duke i përfshirë edhe shpenzimet e procedurës së përmbarimit, në bazë të aktgjykimit PKR.nr.173/17, të datës 12.03.2020, i lëshuar nga Gjykata Themelore në Ferizaj – Departamenti për Krime të Rënda, ose ndalimin në mjetet në para nga xhirollogaria e debitorëve dhe bartjen në xhirollogarinë bankare të debitorit ose sekuestrimin e pengut, kolateralit të lënë peng nga debitorët.

Kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit, i autorizuari i debitorit M.S., brenda afatit ligjor, ka ushtruar prapësim, duke i propozuar gjykatës që prapësimi të aprovohet si i bazuar.

Kreditori në përgjigjen e ushtruar me shkrim, në prapësimin e të autorizuarit të debitorit M.S., i ka propozuar gjykatës që prapësimin e debitorit M.S. ta refuzoj si të pabazuar.

Gjykata në këtë rast i shqyrtoj shkresat e lëndës, urdhrin për përmbarim P.nr.22/2021, të datës 28.01.2021 dhe pretendimet në prapësim të autorizuarit të debitorit M.S., si dhe thëniet e kreditorit në përgjigjen në prapësimin e debitorit dhe vlerësoj se prapësimi i të autorizuarit të debitorit M.S. është pjesërisht i bazuar.

Gjykata vlerëson se urdhri për përmbarim P.nr.22/2021, i datës 28.01.2021, i lëshuar nga përmbaruesi privat S.R., është pjesërisht i ligjshëm dhe i rregullt, përkatësisht është i ligjshëm, sa i përket caktimit të përmbarimit ndaj debitorit M.S. edhe atë për shumën e borxhit prej 2,375 euro dhe për shpenzimet e përmbarimit, kurse nuk është i ligjshëm urdhri për përmbarim sa i përket caktimit të përmbarimit ndaj debitorit B.Sh. edhe atë për shumën e borxhit prej 2,375 euro, dhe për shpenzimet e përmbarimit për debitorin B.Sh., si dhe kamatës së kërkuar nga kreditori prej 8% nga dita e arritshmërisë së kërkesës.

Sa i përket pretendimeve të autorizuarit të debitorit M.S. në prapësim se: përmbaruesja privat S.R. ka qenë dashur të dijë se një propozim i tillë për përmbarim si ai i kreditorit nuk mundë të lejohet me urdhër për përmbarim, pasi që nga vet shkresat e lëndës si aktvendimi PP.nr.51/13, i datës 27.05.2015, aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj P.nr.250/13, i datës 29.04.2015, aktgjykimi PKR.nr.173/17, i datës 12.03.2020 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.282/20, i datës 06.11.2020, vërtetohet se lidhur me dëmin e pësuar të kreditorit dhe sigurimin që ai të zhdëmtohet, Gjykata Themelore në Ferizaj ishte kujdesur sipas detyrës zyrtare, ashtu që Gjykata Themelore në Ferizaj fillimisht më aktgjykimin

P.nr.250/13, të datës 29.04.2015, për kompensimin e dëmit të kreditorit i kishte konfiskuar debitorit B.Sh. shumën prej 4,750.00 euro, kurse më pas me aktgjykimin PKR.nr.173/17, të datës 12.03.2020 e njëjta gjykatë debitorit M.S. i ka konfiskuar 4,090.00 euro, gjykata këto pretendime i konsideron të pabazuara sepse me aktgjykimin PKR.nr.173/17, të datës 12.03.2020, në bazë të cilit është nxjerrë urdhri për përmbarim, nuk është vendosur për konfiskimin e shumave të të hollave siç pretendon i autorizuari i debitorit M.S., kjo sepse në rastin konkret urdhri për përmbarim i atakuar me prapësim nga debitori M.S., është nxjerrë në bazë të aktgjykimit PKR.nr.173/17, të datës 12.03.2020, në të cilin tek pjesa e gjykimit, gjegjësisht në pasuesin (6) gjashtë, Gjykata kishte vendosur që debitorët B.Sh. dhe M.S. t'i detyroj që shumën e dëmit prej 4,750.00 euro t'ia kompensojnë të dëmtuarit, tani kreditorit B.S. edhe atë që të dy në mënyrë solidare, gjegjësisht në pjesë të barabarta, në afatin prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit me detyrim. Për më tepër me këtë aktgjykim nuk është paraparë që nga ndonjë shumë e mjeteve e konfiskuar nga debitorët, të përmbushet detyrimi ndaj kreditorit B.S.

Përveç tjerash, gjykata vlerëson se përmbaruesi privat S.R., me rastin e lejimit të përmbarimit me nxjerrjen e urdhrin të atakuar me prapësim, i ka respektuar në tërësi dispozitat ligjore nga neni 22, par 1, nën par 1.1, të LPP-së, ku aktgjykimi i cekur më lart konsiderohet dokument përmbarimor në bazë të cilit organi përmbarues mund ta caktoj përmbarimin. Për më tepër aktgjykimi në fjalë është i pajisur edhe me klauzolën e përmbarueshmërisë për përmbarueshmëri e paraparë edhe në nenin 36, par 1, të LPP-së. Andaj, edhe duke i marr për bazë faktet e cekura, gjykata konsideron se përmbaruesi privat S.R., me të drejtë dhe në pajtim me dispozitat ligjore të cekura më lart ka vepruar kur e ka nxjerrë urdhrin për përmbarim, përveç për debitorin B.Sh., për të cilin gjykata ka konstatuar se i njëjti pas nxjerrjes së urdhrin për përmbarim e ka përmbushur detyrimin e tij që rrjedh nga aktgjykimi i cekur si dhe i ka paguar edhe shpenzimet e procedurës së përmbarimit, për të cilin gjykata e ka shfuqizuar urdhrin për përmbarim si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Gjykata me rastin e pranimit të prapësimit të autorizuarit të debitorit dhe shfuqizimit të urdhrin për përmbarim P.nr.22/2021, të datës 28.01.2021, sa i përket caktimit të përmbarimit ndaj debitorit B.Sh. edhe atë për shumën e borxhit prej 2,375 euro, dhe për shpenzimet e përmbarimit për debitorin B.Sh., si dhe kamatës së kërkuar nga kreditori prej 8% nga dita e arritshmërisë së kërkesës, mori për bazë shënimin zyrtar P.nr.22/2021, të datës 12.02.2021, i përpiluar nga Përmbaruesi privat S.R., si dhe kopjes së transferit bankar të datës 12.02.2021, të lëshuar nga Banka për Biznes, në bazë të cilëve, gjykata konstaton se debitori B.Sh., e ka

përmbushur në tërësi detyrimin e tij që rrjedh nga aktgjykimi PKR.nr.173/17, i datës 12.03.2020, siç pagesa e shumës së mjeteve prej 2,375 euro, si dhe pagesën e shpenzimeve të përmbarimit në pjesën që i ka takuar si detyrim debitorit B.Sh.. Po ashtu, Gjykata konstaton se në aktgjykimin e cekur më lart, në bazë të cilit është nxjerrë urdhri për përmbarim i atakuar me prapësim, gjegjësisht në pjesën në të cilën janë obliguar debitorët, respektivisht tani debitori M.S. për pagesën e shumës së mbetur të borxhit prej 2,375 euro, ndaj kreditorit, nuk është paraparë që përveç shumës së mjeteve, debitori të detyrohet të paguaj dhe kamatën prej 8%, siç e ka kërkuar kreditori nga dita e arritshmërisë së kërkesës, dhe Gjykata, urdhrin e atakuar me prapësim, sa i përket debitorit B.Sh. edhe atë për shumën e borxhit prej 2,375 euro, dhe për shpenzimet e përmbarimit për debitorin B.Sh., si dhe kamatës së kërkuar nga kreditori prej 8%, e cilëson të kundërligjshëm dhe për këtë arsye vendosi që për këtë pjesë ta shfuqizoj urdhrin e atakuar.

Nga të cekurat më lart dhe bazuar në nenin 73, par 1, 2 dhe 3, të LPP-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

PPP.nr.129/22, më datë 15.03.2024

GJYQTARI

Faton Ajvazi

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në afatin prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi.